

## Shpjegim i "Libri i teuhidit" – 8

(E drejta e Allahut ndaj njerëzve)

Mësimet të mbajtura nga dijetari i njohur Salih Ibn Abdul Aziz Muhamed Ali Shejh

(Allahu e faltë atë, prindërit e tij dhe të gjithë muslimanët!)

Përkthyes: Bilbil Talla

Redaktor: Ilir Haxhiaj

### **Kapitulli: Vepra shirku janë: Varja e r Rathëve, e perit e të ngjashme, për largimin apo pengimin e sprovave.**

Allahu i Madhërishëm thotë:

"Thuaju: "Si mendoni, nëse Allahu dëshiron të më shkaktojë ndonjë dëm, a mund ta largojnë atë idhujt që ju i adhuroni krahas Tij?! Po nëse Ai dëshiron të më mëshirojë, a mund ta pengojnë ata mëshirën e Tij?!" Thuaju: "Mua më mjafton Allahu. Tek Ai le të mbështeten ata që kërkojnë mbështetje!"<sup>1</sup>

Imran Ibn Husejn<sup>2</sup> – Allahut qoftë i kënaqur e me të! – përcjell se Profeti – paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të! – pa njëherë në dorën e një personi një rreth prej bakri dhe i tha: "Çfarë është ajo?" Ai tha: "Është prej *el uahine*"<sup>3</sup>.<sup>4</sup> Profeti i tha: "Hiq atë, se ajo ta shton dobësinë! Po të vdesësh me të në dorë, nuk ke për të shpëtuar kurrë!" E sjell Imam Ahmedi, me varg transmetuesish të pranueshëm.<sup>5</sup>

Ukbe Ibn Amiri<sup>6</sup> përcjell se Profeti – paqja dhe bekimi i Allahut qoftë me të! – ka thënë: "Kush var hajmali<sup>7</sup>, Allahu mos ia plotësoftë! Dhe kush var guaskë, Allahu mos i dhëntë rehati!"<sup>8</sup> Në një tjetër transmetim thuhet: "Kush var hajmali, ka rënë në shirk."<sup>9</sup>

<sup>1</sup> EZ-ZUMER: 38.

<sup>2</sup> Ai është: Prijësi shembullor Imran Ibn Husejn Ibn Abid ebu Nexhid el Huzajj, sahab i Profetit (Paqja e Allahut qoftë mbi të!). E pranoi Islamit në vitin e shtatë të hixhretit. Umeri e dërgoi tek banorët e Basras, që t'i mësonte ata. Hasani (el Basrij) betohej se në Basra nuk kishte mbërritur njeri më i mirë se ai. Shih: "Sejr Ealam el Nubela": 2/508 dhe "Tehdhib el Kemal: 22/319.

<sup>3</sup> Në etimologji ka kuptimin: dobësuese. (shënim i përkthyesit)

<sup>4</sup> "*El uahine*" është një nerv që prek nga shpatulla deri tek duart. Thuhet gjithashtu se është një sëmundje që prek shpatullën dhe vetëm burrat. Shih: *El Nihaje fi Garib el Hadith: 5/233.*

<sup>5</sup> Shënon Imam Ahmedi: 4/445, nr: 20.000; Ibn Hibani: 13/449, nr: 6085; Ibn Maxheh: 3531.

<sup>6</sup> Ai është: Ebu Abes Ukbe Ibn Amir el Xhuhenij, sahab i Profetit (Paqja e Allahut qoftë mbi të!), si dhe njëri prej mbledhësve të Kuranit. Ai lexonte, ishte orator dhe njihnte mirë fushën e trashëgimisë dhe të fikhut. Shih: "*Tedhkiratu el Hufadh*": 1/42 dhe "El Isabe: 4/520.

<sup>7</sup> Me synimin që të jetë plotësisht i mbrojtur. (shënim i përkthyesit).

<sup>8</sup> Shënon Ahmedi: 4/154; nr: 17404. Ebu Jeala: 3/295; nr: 1759. Ibn Hibani: 13/450; nr: 6086.

<sup>9</sup> Shënon Ahmedi: 4/156; nr: 17422. Hakimi: 4/219.

Ibn Ebu Hatimi<sup>10</sup> përcjell hadithin e Hudhejfes,<sup>11</sup> që tregon se ai kishte parë njëherë një person që bartte një pe të lidhur në dorë për t'u shëruar nga ethet. Ai ia këputi atë dhe lexoi ajetin kuranor: "Shumica e tyre nuk besojnë në Allahun pa i shoqëruar Atij njëkohësisht të tjerë (idhuj të rremë) në adhurim."<sup>12</sup><sup>13</sup>

Dobitë e temës

- Qortimi i rëndë për mbajtjen e rathëve, të perit e gjërave të ngjashme.
- Edhe sahabi i Profetit, po të vdiste me to në dorë, nuk do të shpëtonte. Kjo argumenton thënien e sahabëve të Profetit se: Shirku i vogël është më i rëndë sesa gjynahu më i madh.
- Mosjustifikimi me padijen.
- Mbajtja e gjërave të tilla nuk bëjnë dobi, madje sjellin dëm, pasi Profeti tha: "Ajo ta shton dobësinë".
- Kritikimi dhe qortimi i rëndë i atij që e bën një gjë të tillë.
- Thënia e qartë se: kush mban diçka për fat e mbarësi, do të lihet në dorën e saj.
- Thënia qartë se, kush mban hajmali, ka rënë në shirk.
- Edhe varja e perit për ethet bën pjesë në të njëjtën kategori.
- Leximi i ajetit kuranor nga Hudhejfja tregon se sahabët mbështeteshin në ajetet ku përmendet shirku i madh mbi shirkun e vogël, sikurse ka ndodhur edhe nga Ibn Abbasi me ajetin e sures Bekare<sup>14</sup>.
- E tillë është edhe varja guaskave për t'u ruajtur nga syri i keq.
- Lutja kundër atij që var hajmali, që Allahu të mos ia plotësojë dëshirën dhe që, kush var guaskë, të mos e lërë të qetë.

\*\*\*\*

Në këtë kapitull, Shejhu shpjegon çështjen e mësipërme, që ka të bëjë me sqarimin e teuhidit, duke shpjeguar ato gjëra që bien në kundërshtim me të.

<sup>10</sup> Ai është: Abdurrajman Ibn Muhamed Ibn Idris, i njohur si: Ibn Ebi Hatim. Ai ishte det i diturisë, njohës i mirë i jetëshkrimeve të njerëzve dhe detajet e hadithit. Vdiq në vitin 327h. shih: "*Tedhkiratu el Hufadh*": 3/829 dhe: "*Lisan el Mizan*": 3/432.

<sup>11</sup> Ai është: Hudhejfe Ibn el Jemani, mbajtësi i sekretit të Profetit (Paqja e Allahut qoftë mbi të!) dhe prej muEL-HAXHirëve më të shquar. Përcolli shumë hadithe nga Profeti (Paqja e Allahut qoftë mbi të!), që kanë të bëjnë me konfliktet dhe parashenjat e Kijametit. Vdiq në vitin 36h. Shih: "*Sejr Ealam el Nubela*": 2/361 dhe: "*Tabekat Ibn Sead*" 7/317.

<sup>12</sup> JUSUF 106

<sup>13</sup> Tefsiri i Ibn Ebu Hatimit: 7/2208, nr. 12040.

<sup>14</sup> Është fjala për ajetin: "Megjithatë, disa njerëz zgjedhin (për të adhuruar) në vend të Allahut (zota) të tjerë, (duke i konsideruar) si të barabartë me Atë dhe duke i dashur siç duhet Allahu." (EL-BEKARE: 165). Shih edhe: "*Zad el Mujesser*": 1/170.

Është i ditur fakti se diçka mund të njihet përmes karakteristikave të vetë asaj dhe duke njohur të kundërtat e saj. Poeti thotë:

*E kundërta, bukurinë e të kundërtës sqaron  
e kundërta gjërat i dallon.*<sup>15</sup>

Kjo është e vërtetë, pasi teuhidi mund të kuptohet duke e njohur atë, domethënë duke njohur kuptimin dhe subjektin e tij, por edhe duke njohur të kundërtën e tij. Kështu, teuhidi mund të kuptohet sa i mirë është, po të kuptohet se sa i shëmtuar është shirku. Për këtë, edhe imami (Allahu e mëshiroftë!) filloi duke sqaruar të kundërtat e teuhidit.

Disa nga të kundërtat e teuhidit bien ndesh me të që në themel, siç është shirku i madh që, nëse një i përgjegjshëm bie në të, ka rrënuar teuhidin, dhe ky konsiderohet se ka rënë në shirk të madh, i cili e përjashton nga radhët e besimtarëve muslimanë. Për personin e tillë mund të thuash se ka bërë një veprim që bie ndesh kryekëput me teuhidin apo me themelin e tij.

Po ka nga të kundërtat e teuhidit që cenojnë teuhidin e plotë, pa e shkatërruar tërësisht atë, siç është rënia në shirk të vogël. Nëse dikush bie në të, ai ka bërë diçka që bie ndesh me teuhidin e plotë. Kjo, pasi teuhidi është i plotë kur një person arrin të hedhë tej të gjitha llojet e shirkut.

Edhe syfaqësia është pjesë e shirkut të vogël. Është fjala për syfaqësinë e lehtë. Syfaqësia e lehtë bie ndesh me teuhidin e plotë.

Pjesë e shirkut të vogël janë edhe gjëra të tjera, për të cilat dijetarët thotë se përmbajnë disa forma të shirkut. Termat që ata përdorin, dhe të cilat ne do t'i trajtojmë në këtë kapitull, janë katër:

1. shirku i madh
2. shirku i vogël
3. shirku i fshehtë

Një rast i katërt është, për disa dijetarë, kur një çështje a veprim përmban forma ose aspekte shirku, për shembull: "Ata e dinë dhuntinë e Allahut, por pastaj e mohojnë, se shumica e tyre janë jobesimtarë."<sup>16</sup> dhe: "A mos vallë, ata i veshin Atij si ortakë idhuj që nuk mund të krijojnë asgjë, ndërsa që edhe vetë janë të

<sup>15</sup> Shih: *Medarixh el Salikin*: 1/144.

<sup>16</sup> EN-EN-NAHL: 83.

krijuar?!"<sup>17</sup> Këto lloje të shirkut depërtojnë në fushën e adhurimeve, siç do të trajtohet më poshtë me detaje, me leje të Allahut.

Shejhu - Allahu e mëshiroftë – e filloi këtë kapitull me sqarimin dhe pasqyrimin e disa formave të shirkut të vogël, që është shumë i përhapur. Ai filloi me trajtimin e shirkut të vogël para shirkut të madh, me synimin për të kaluar nga i vogli tek i madhi, për shkak se dyshimi për shirkun e vogël është më pak i qartë se dyshimi për shirkun e madh, i cili është më i qartë. Dyshimi që lidhet me fijen e perit dhe hajmalitë është më i dobët, në krahasim me dyshimin që lidhet me "eulijatë" (njerëzit e mirë) dhe të devotshmit. Kur një person që lidh një pe apo mban një hajmali e gjëra të tjera të ngjashme, mëson se një veprim i tillë është gabim, e ka më të lehtë të bindet mbi pavlefshmërinë e mbështetjes tek eulijatë dhe njerëzit e mirë e jo tek Allahu i Madhërishëm, kur e dyta – shirku i madh - është më e shëmtuar dhe flagrante se e para. Sakaq, kur para vetes ke një person i cili ka rënë në shirkun e madh, siç është ai që shpresat e tij i var tek eulijatë, u lutet atyre, u kërkon atyre, ther kurban për ta, nuk është e udhës që të përpiqemi t'i shpjegojmë dhe ta bindim për pavlefshmërinë e veprimit të tij, duke kaluar nga diçka më e madhe tek diçka më e vogël, pasi dyshimi brenda tij është më i fortë, duke qenë se ai pretendon se ata njerëz kanë një pozitë të caktuar tek Allahu i Madhërishëm. Ky është realiteti i gjendjes së tyre. Ata u luten atyre dhe bien në shirk të madh, vepër që të nxjerr nga bashkësia muslimane -Allahu na ruajt!

Ata thonë: synimi ynë është që ata të ndërmjetësojnë me pozitën e lartë që kanë tek Allahu. Gjendja e tyre është e njëjtë me të politeistëve në kohën e Profetit (Paqja e Allahut qoftë mbi të!). Në lidhje me ata, Allahu i Madhërishëm thotë: "Sa për ata që marrin mbrojtës të tjerë, përveç Tij, duke thënë: "Ne u lutemi atyre vetëm që të na afrojnë tek Allahu..."<sup>18</sup>

Qëllimi: Shejhu (Allahu e mëshiroftë!) e filloi këtë kapitull së pari, duke trajtuar shirkun e vogël, për të kaluar nga diçka më e vogël tek diçka që është më e madhe, që kjo të përbëjë një argument më të fortë dhe mundësia për të arritur brenda ndërgjegjes së njerëzve të jetë më e madhe, në mënyrë që ata të sqarohen për domosdoshmërinë e lidhjes vetëm me Allahun dhe të heqin dorë nga të gjitha lidhjet e tjera.

Autori (Allahu e mëshiroftë!) thotë: "Vepra të shirkut janë...". Fjala "Vepra" këtu është në trajtën e pashquar, çka tregon se format e përmendura në këtë kapitull janë disa nga format e shirkut dhe jo të gjitha. Por pyetja është: "me disa" është

<sup>17</sup> EL- A'RAF: 191.

<sup>18</sup> EZ-ZUMER: 3.

fjala për disa njësi të tij, apo disa lloje të tij? Përgjigjja: Të dyja, pasi kur përmendet se varja e rrathëve apo lidhja e perit, që bëjnë pjesë në llojin e shirkut të vogël, ato njëkohësisht janë njësi të shirkut në përgjithësi, sepse ato janë disa forma shirkut.

"Vepra shirku janë: Varja e rrathëve, e perit, e të ngjashme".

Qëllimi me "e të ngjashme" është të ngjashme me rrethin, perin, guaskën, hajmalitë, copëzat e metalit dhe gjëra të tjera, që mund të mbahen për mbarësi. Të ngjashme janë edhe ato që varen në shtëpi, në makinë, gjërat që u varen fëmijëve e të tjera gjëra që vishen apo varen. Të gjitha bëjnë pjesë në këtë kapitull dhe janë pjesë e shirkut.

Rrethi mund të jetë prej bakri, prej hekuri dhe prej çdo lloj metali tjetër. Lidhja me pe është ajo që lidhet në dorë me një besim të caktuar dhe jo për lidhjen e ndonjë peri specifik. Arabët kishin besëtytni në lidhje me rrethin, perin e të ngjashme me to, si hajmalitë etj. Ata besonin se kush varte diçka prej tyre, do të kishte ndikim dhe dobi ose në ruajtjen nga sprovat para rënies, ose në largimin e sprovës a të sëmundjes pas rënies së saj. Prandaj edhe Shejhu (Allahu e mëshiroftë!) tha: "për largimin apo pengimin e sprovave". Që të dyja këto situata janë të pranishme. Disa i varin rrathët dhe lidhin fijet e perit e të ngjashmet me to para rënies së sprovave, në mënyrë që të ruhen prej tyre. Nuk ka dyshim se ky veprim është më i rëndë dhe gjynah më i madh se i atij që i vepron këto gjëra me qëllimin e largimit të sprovës pas rënies së saj, sepse ai mendon se këto gjëra të pavlera e të ulëta e sprapsin caktimin e Allahut të Lartësuar. Kështu grupi i parë janë këta që sapa përmendën.

Ndërsa grupi i dytë janë ata që i lidhin a i veshin këto gjëra në trup, me qëllim që t'u largohet ndonjë e keqe që u ka rënë. Dikush sëmuret, për shembull, dhe lidh një pe, me qëllim që të shërohet. Dikush tjetër, që e ka zënë mësyshi, lidh një fije peri për t'u çliruar nga mësyshi etj.

Pyetje: Përse varja e një rrethi apo lidhja e një peri në trup është shirk i vogël?

Përgjigjja: Sepse zemra është e lidhur dhe e varur pas këtyre gjërave dhe i konsideron ato si shkaqe për largimin ose pengimin e të këqijave.

Rregulli për këtë çështje thotë: Vetëm Sheriati mund të konfirmojë se shkaqe dhe sende të caktuara janë me ndikim. Nuk lejohet që diçka të konsiderohet si 'shkak ndikues pa u pohuar një gjë e tillë nga Sheriati ose pa u vërtetuar në praktikë se ndikon vërtet, në mënyrë të dukshme dhe jo të paqartë. Ai që var një rreth apo lidh një pe etj., për largimin apo pengimin e të këqijave, i ka konsideruar ato si

shkaqe që nuk janë përiligjur nga Sheriati. Madje edhe në aspektin praktik ndikimi i tyre nuk është i qartë e i prekshëm. Është vetëm besëtytnia që i shtyn këta njerëz të bëjnë gjëra të tilla, që në fund pastaj mund të korrespondojë me caktimin e Allahut. Një person mund të shërohet që në fillim të përdorimit apo edhe pas tyre dhe zemra e tij varet prej tyre. Kështu, njeriu mendon dhe beson se shkaktari i arritjes është sendi i përdorur prej tij. Dhe kjo është e pavlerë.

Ndërsa arsyeja përse mbajtje e rrahëve, penjve dhe e gjërave të ngjashme për largimin apo për pengimin e sprovave janë shirk, është se pasi personi që i përdor këto gjëra e lidh zemrën e tij pas tyre. Ajo mendon se ato e ruajnë dhe i sjellin dobi, apo se ndikojnë në largimin e një dëmi, a arrijen e një dobie. Në realitet, këto gjëra janë vetëm në dorën e Allahut të Lartësuar. vetëm Ai sjell dobi dhe dëm. Allahu - i Lartësuar qoftë! - është burimi i mirësive pa fund. Ai derdh mirësinë e Tij mbi krijesat ose mund t'i privojë ata prej saj.

Që disa shkaqe të konsiderohen sindikuese duhet që ato të jenë të lejuara nga Sheriati. Për këtë arsye, disa dijetarë kanë thënë: Kush pretendon se një shkak është veprues dhe me ndikim, ndërkohë që Allahu nuk e ka bërë të tillë as në fe e as në praktikë, ka bërë shirk, domethënë ka bërë shirk të vogël.

Ky rregull është i saktë përgjithësisht, edhe pse renditja brenda tij e disa shembujve mund të mos jetë shumë i qartë. Megjithatë, ky kapitull ka për qëllim të theksojë që shkaqet duhet domosdoshmërisht të konsiderohen të tilla ose nga Sheriati, ose nga praktikat e qarta, siç është bari i mjekut, ose kur përfitimi prej tyre është i dukshëm, siç është fakti se zjarri të ngrohë, uji të ftohë, e të ngjashme. Këto shkaqe është e qartë se janë me ndikim dhe përfitimi prej tyre është i dukshëm.

Nga kjo arrijmë në përfundimin se varja e zemrës te diçka për të larguar sprovën a për ta penguar atë, në rast se Zoti nuk e ka bërë shkak dhe nuk e ka lejuar, është një lloj i shirkut. Ky është edhe synimi i Shejhut në këtë kapitull: përdorimi i një peri ose rrethi është shirk i vogël.

Kujtesë: Të gjitha format e shirkut të vogël mund të jenë edhe shirk i madh. Kjo varet nga gjendja e atij që i vepron këto gjëra. Në origjinë, përdorimi i rrethit, i perit, mbajtja e hajmalive, betimi në dikë tjetër jo në Allah, thënia “ç’të dëshirojë Zoti dhe ti” dhe vepra, besime dhe fjalë të tjera janë vepra të shirkut të vogël, por mund të kalojnë edhe në shirk të madh, sikurse thamë, në varësi të personit që i vepron këto gjëra. Në rast se dikush mendon se rrethi dhe peri ndikojnë në vetvete, ky është shirk i madh, pra, nëse mendon se ato nuk janë thjesht shkaqe, por ndikojnë vetvetiu në pengimin ose largimin e një dëmi, një sëmundjeje apo mësyshit. Kjo, pasi ky person i ka dhënë rol veprues në gjithësi diçkaje tjetër

përveç Allahut të Madhërishëm, kur dihet se një gjë e tillë është prej njësive të teuhidit të *rububije-s*, ndaj edhe raste të tilla klasifikohen si shirk në teuhidin e *rububije-s*.

Qëllimi i këtij kapitulli lidhet me varjen e shpresave tek këto gjëra, siç janë përdorimi i rrethit, i perit, e të ngjashme me to, për pengimin e fatkeqësive, apo edhe për largimin e tyre, pasi kanë ndodhur. Më pas Shejhu sjell ajetin kuranor:

"Thuaju: Si mendoni, nëse Allahu dëshiron të më shkaktojë ndonjë dëm a mund ta largojnë atë idhujt që ju i adhuron krahas Tij?! Po nëse Ai dëshiron të më mëshirojë, a mund ta pengojnë ata mëshirën e Tij?!" Thuaju: "Mua më mjafton Allahu. Tek Ai le të mbështeten ata që kërkojnë mbështetje"

"Thuaju: Si mendoni, idhujt që ju i adhuron krahas Allahut...?!<sup>19</sup>" Mendimi i disa dijetarëve është se shkronja "fa", kur vjen pas pjesëzës "a", është lidhëria e një fjalie të hequr, por që kuptohet nga konteksti. Filli i këtij ajeti është: "Nëse ti (o Muhamed) i pyet ata (mekasit paganë) se kush i ka krijuar qiejt dhe Tokën, me siguri që do të të thonë: "Allahu". Thuaju: "Si mendoni..."<sup>20</sup> domethënë: "Thuaj: A e pranoni se Ai, i cili krijoi qiejt edhe tokën është vetëm Allahu, e megjithëkëtë ju lusni dhe iu drejtoheni të tjerëve. A e pranoni këtë dhe i veproni këto gjëra?!"

Apo, pjesa e nënkuptuar mund të jetë: A e pranoni se Allahu i Madhërishëm është i vetmi në "rububije" dhe se është vetëm Ai që i ka krijuar qiejt edhe tokën. Nëse ju e pranoni këtë, si mendoni për këto gjëra që ju i adhuron dhe të cilave ju i drejtoheni, a janë në gjendje që t'ju shmangin dëmin?

Nëse do të ishte kjo, shkronja "fa" këtu është rendore dhe koordinon pjesën e që vjen pas me atë të përparmen. Ky është edhe qëllimi i këtij debati, pasi metoda e ndjekur nga Kurani është debati me politeistët përmes gjërave të pranuar prej tyre në teuhidin *rububije*, mbi gjërat që i mohojnë në teuhidin *uluhije*. Ata e pranojnë teuhidin *rububije*, prandaj për rrjedhojë, ata duhet të heqin dorë nga adhurimi i gjithçkaje tjetër përveç Allahut të Madhërishëm.

- 'ted'une' – adhuron. Adhurim është lutje ose kryerja e veprave të tjera të adhurimit.

<sup>19</sup> Për t'u përshtatur me trajtimin që i bën autori këtij ajeti është bërë një ndryshim në formulimin e ajetit dhe jo në përmbajtje, ndryshe nga ai që ndodhet në Kuranin e përkthyer në gjuhën shqipe të profesor Hasan I. Nahit, botim i AIITC, të cilin ne kemi marrë për bazë këtu. (shënim i përkthyesit)

<sup>20</sup> EZ-ZUMER: 38.

- *'ted'une'* përmbledh lutje-kërkesën dhe lutjen e adhurimit, pasi të dyja këto janë përjetime të politeistëve.

Përemri e pyetës "ma" në ajetin "ma ted'une" (që ju i adhuroni) është gjithëpërfshirës, pasi është lidhor me kuptimin "i cili", domethënë: Si mendoni atë të cilin ju adhuroni, përveç Allahut?

Adhurimet e tyre janë të llojllojshme. Ato përfshijnë gjithçka që iu drejtohen lutje, përveç Allahut, që janë sqaruar në Kuran. Në Kuran janë përmendur format e shirkut në Allah dhe të gjërave që u janë drejtuar me lutje. Ato janë:

1. Adhurimi i disa profetëve, të Dërguarve dhe njerëzve të mirë, sikurse është përmendur në Kuran, në suren Maide: "Pastaj Allahu do të thotë (në Ditën e Gjykimit): "O Isa, i biri i Merjemes! Ti ishe ai që u the njerëzve: "Adhuromëni mua dhe nënën time si zota krahas Allahut"?! Isai do të thotë: "Qofsh i lartësuar dhe i lavdëruar...!"<sup>21</sup> Ky ajet bën fjalë për këtë lloj shirku.

2. Adhurimi i engjëjve, sikurse është përmendur në Kuran, në suren Sebe: "Ditën kur do t'i tubojë të gjithë, do t'u thotë engjëjve: "Vallë, këta juve ju adhuroni?" Ata do të thonë: "Qofsh i lavdëruar Ti, o Zoti ynë! Ti je Mbrojtësi ynë, jo ata. Ata adhuroni xhindët dhe shumica e mohuesve u besonin atyre."<sup>22</sup>

Një grup tjetër politeistësh adhuroni dhe iu drejtoheshin me lutje planetëve, siç ishin ata që adhuroni diellin, hënën dhe planetë të tjerë. Një grup tjetër politeistësh adhuroni dhe iu drejtoheshin me lutje pemëve dhe gurëve. Një tjetër ikonat dhe idhujt. Në këtë mënyrë, thënia e Allahut të Madhërishëm: "Thuaju: Si mendoni, idhujt që ju i adhuroni krahas Allahut...?!" përfshin gjithçka që i drejtohen me lutje apo forma adhurimi. Kjo na ndihmon edhe për të kuptuar aspektin argumentues me ajetin, siç do të vijojë më pas.

"Nëse Allahu dëshiron të më shkaktojë ndonjë dëm, a mund ta largojnë atë idhujt që ju i adhuroni krahas Tij?! Po nëse Ai dëshiron të më mëshirojë, a mund ta pengojnë ata mëshirën e Tij?!"<sup>23</sup> Ky ajeti mohon që të gjithë ato zota që adhurohen mund të sjellin dëm a dobi. Pra, ajeti: "Nëse Allahu dëshiron të më shkaktojë ndonjë dëm, a mund ta largojnë atë idhujt që ju i adhuroni krahas Tij?!" domethënë që ata nuk mundën ta bëjnë një gjë të tillë.

<sup>21</sup> EL-MA'IDE: 116.

<sup>22</sup> SEBE': 40-41.

<sup>23</sup> EZ-ZUMER: 38.



Po kështu edhe: "Nëse Allahu dëshiron të më mëshirojë, a munden këto zota të më largojnë nga mëshira e Tij?" Pra, ata edhe këtë gjë nuk munden ta bëjnë. Në këtë mënyrë, Allahu i Madhëruar zhvlerëson lidhjen me idhujt të cilët mendohen të kenë pozita ndërmjetësuese tek Ai.

Disa dijetarë mendojnë se ajeti i mësipërm lidhet me shirkun e madh, atëherë përse autori (Allahu e mëshiroftë!) e përmend atë në fillim të trajtimit të llojeve të shirkut të vogël? Përgjigjja për këtë jepet në dy aspekte:

1. Kuptimi i ajeteve të ardhura për shirkun e madh tregon për domosdoshmërinë e lidhjes me Allahun dhe heqjen dorë nga lidhjet e tjera. Ky kuptim gjendet edhe në shirkun e vogël. Prandaj disa prej të parëve tanë ajetet që kanë zbritur për shirkun e madh i kanë zbatuar edhe për shirkun e vogël, nisur nga fakti se në të dy llojet e shirkut ka lidhje dhe varësi tek diçka tjetër përveç Allahut të Lartësuar, ndaj, nëse duhet të hiqet dorë nga diçka e madhe, atëherë heqja dorë nga diçka tjetër më e vogël është më parësore.

2. Ky ajet bën fjalë për shirkun e madh, por kuptimi që vërtitet rreth tij është pohimi se çdokush që lutet përveç Allahut nuk ka asgjë në dorë. Ai nuk mundet të largojë dëmin e as sprovën dhe nuk mundet, gjithashtu, të pengojë mëshirën dhe mirësitë ndaj atij që Allahu ia dëshiron një gjë të tillë. Ky kuptim, që është lidhja pas asaj që sjell dëm dhe dobi, është i njëjti për shkakun e të cilit personi bie në shirk të vogël duke mbajtur ndonjë rreth, duke lidhur pe a gjëra të tjera në trup, për faktin se ai beson që të dyja kanë ndikim në largimin apo pengimin e një të keqeje dhe se të dyja sjellin dobi dhe shmangin dëm, paçka se këto gjëra janë pa vlerë dhe të ulëta. Nëse mohohet dobia nga gjërat e mëdha, siç janë profetët, të Dërguarit, engjëjt, njerëzit e devotshëm, apo ikonat dhe statujat të cilat janë aspekte shpirtërore sikur shprehen, nëse mohohet dobia dhe dëmi nga këto, argumenti për gjërat e tjera pastaj që janë më të ulëta dhe më pa vlerë është më i qartë.

Thënia "ndonjë dëm" në kontekstin e fjalisë "Nëse Allahu dëshiron të më shkaktojë ndonjë dëm" është në formën jokonkrete në rrjedhën e kushtores. Në këtë mënyrë, ajo përfshin të gjitha llojet e dëmeve, domethënë: përveç Allahut të Madhërishëm, apo me lejen e Tij, askush nuk mundet ta largojë dëmin, çfarëdo qoftë ai, nëse Allahu vendosë ta hedhë mbi dikë.

Pastaj autori rendit në këtë kapitull një sërë hadithesh, si vijon:

Imran Ibn Husejn<sup>24</sup> –Allahut qoftë i kënaqur e me të! – transmeton se njëherë, Profeti – paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të! – pa në dorën e një personi një rreth prej bakri, prandaj i tha: “Çfarë është ajo?” Ai tha: “Është prej *el uahine*” . Profeti i tha: “Hiq atë, se ai ta shton dobësinë, madje po të vdesësh me të në dorë, nuk ke për të shpëtuar kurrë!”

Përkimi i hadithit me temën është i qartë; profeti (Paqja e Allahut qoftë mbi të!) pa një person që në dorën e tij mbante një rreth prej bakri. Para Islamit, njerëzit kishin shpresa se mbajtja e një rrethi prej bakri do t’u sillte dobi apo do t’u largonte të keqen, ndaj Profeti (Paqja e Allahut qoftë mbi të!) e pyeti: “Çfarë është ajo?” Për sa i përket llojit të pyetjes në këtë hadith, dijetarët thonë se pyetja është retorike dhe qortuese. Megjithatë, personi i pyetur nuk e kuptoi se ajo ishte e tillë, por mendoi se ishte thjesht një pyetje sqaruese, prandaj dhe iu përgjigj duke i thënë se ishte "*el uaheneh*". Disa të tjerë mendojnë se pyetja mund të ketë qenë sqaruese, por edhe retorike qortuese. Më me gjasë është e para, domethënë se pyetja ishte në formë qortuese. Është kjo më e mundur, nisur nga konteksti, pasi ai nuk na lejon të mendojmë se pyetja ishte thjesht për sqarim të arsyes se përse personi i tillë mbante një rreth, për shembull për zbukurim. Pyetja nuk nënkuptonte dëshirën për të ditur arsyen e mbajtjes së rrethit a lidhjes me ndonjë lloj besëtytnie apo me arsye të tjera?

Megjithatë, edhe sikur të ishte e natyrës sqarim kërkuese, përgjigjja: “Është *el uahine*” jep arsyen e saktë të mbajtjes së tij. Kështu, në të dy rrethanat, arsyeja e mbajtjes së rrethit ishte për faktin se personi kishte varur shpresën tek ai. "*El uahine*” është një lloj sëmundje, që dobëson trupin dhe këput fuqitë. Thënia e Profetit (Paqja e Allahut qoftë mbi të!): “Hiq atë!” është në formën urdhërore. Kjo provon se diçka e papranueshme mund të ndryshohet edhe me gjuhë, në rast se personi i urdhëruar i bindet. Në një rast të tillë, vetëm kaq mjafton. Arsyeja është se Profeti (Paqja e Allahut qoftë mbi të!) gëzonte të drejtën e udhëheqësit, prandaj kishte mundësi të ndryshonte gjërat e papranueshme edhe me dorë, por duke qenë se ai e dinte që personit i urdhëruar do t’i bindej, i tha vetëm: “Hiq atë!” Në këtë mënyrë, nuk kemi të bëjmë me mospërputhje të këtij hadithi dhe hadithit të Hujdhejfes (Allahu qoftë i kënaqur me të!), i cili e këputi me dorën e tij perin nga dora e një personi, pasi ajo ishte një situatë ndryshe nga kjo.

<sup>24</sup> Ai është prijësi shembullor Imran Ibn Husejn Ibn Abid ebu Nexhid el Huzajj. Sahab i Profetit (Paqja e Allahut qoftë mbi të!). Ai e pranoi Islamit në vitin e shtatë të hixhretit. Umeri e dërgoi tek banorët e Basras, që t’i mësonte ata. Hasani (el Basrij) betohej se në Basra nuk kishte mbërritur njeri më i mirë se ai. Shih: "Sejr Ealam el Nubela": 2/508 dhe "Tehdhib el Kemal: 22/319.

Thënia "se ajo ta shton dobësinë" domethënë se dëmi që vjen prej saj është më i mundshëm sesa dobia. Dëmi i çdo lloj shirku është më i madh se dobia, nëse supozojmë se ai ka ndonjë dobi.

Në lidhje me thënien e Profetit (Paqja e Allahut qoftë mbi të!) "Hiq atë, se ajo ta shton dobësinë!", - dijetarët kanë thënë se kuptimi është se ndikim i saj do të ishte i dëmshëm shpirtërisht dhe psikologjikisht, pasi besëtytnia e dobëson shpirtin dhe moralin. Kështu, varja e shpresave tek një rreth apo fije peri është shkak dobësie. Thënia "ajo ta shton dobësinë" shpreh gjendjen e atyre që bëjnë shirk, pasi veprimi i tyre i çon ata nga dëmi në dëm, edhe nëse mendon në to ka ndonjë dobi.

Thënia e Profetit (Paqja e Allahut qoftë mbi të!): "Sikur të vdesësh me të në dorë nuk ke për të shpëtuar kurrë." Kjo pasi gjendja e personit që var shpresat tek gjëra të tilla është e ndryshme. Ndodh që ato gjëra ai i mban se ato ndikojnë vetvetiu. Po ashtu mund t'i mbajë ato duke menduar se ato janë shkaktare. Duke qenë se ai që mbante rreth në dorë ishte një sahab, në mënyrë të padiskutueshme arrijmë në përfundimin se ai e mbante atë duke besuar se rrethi ishte thjesht një shkak, jo se ndikonte në mënyrë të pavarur.

Dobi tjetër qëndron në thënien e Profetit (Paqja e Allahut qoftë mbi të!): "...nuk ke për të shpëtuar kurrë." Ajo vliente si këshillë për sahabin dhe është për të tjerët, duke sqaruar edhe pasojën e asaj veprë.

Pasoja e shprehur në këtë hadith (nuk ke për të shpëtuar) mund të ketë kuptime të ndryshme, në varësi të gjendjes. Ka raste kur humbja është e plotë, duke nënkuptuar privimin nga Xheneti dhe përjetësinë në Zjarr. Kjo ndodh në rastin kur personi që mban gjëra të tilla, beson se ato ndikojnë në mënyrë të pavarur, pasi kështu kemi të bëjmë me shirk të madh.

Kuptimi i tjetër mund të jetë humbja e një grade të së mirës, dhe kjo ndodh kur personi ka rënë në shirk të vogël. Ky është rasti kur ai mendon se ato gjëra janë thjesht sebepe për arritjen e të mirës. Gabimi është se ky person ka konsideruar si shkak ndikues diçka që nuk është bërë e tillë as nga Allahu, as në Sheriat dhe as në praktikë.

Absolutja e diçkaje dhe diçka absolute janë dy terma që përdoren shpesh në shkrimet e dijetarëve dhe në librin e teuhidit në mënyrë të veçantë. Në këto shkrime mund të konstatosh për shembull thënien: teuhidi absolut dhe absolutja e teuhidit, Islami absolut dhe absolutja e Islamit, imani absolut dhe absolutja e imanit, shirku absolut dhe absolutja e shirkut, shpëtimi absolut dhe absolutja e

shpëtimit, hyrja absolute dhe absolutja e hyrjes, ndalimi absolut dhe absolutja e ndalimit; domethënë privimi nga hyrja në Xhenet apo ndalimi i hyrjes në Zjarr dhe absolutja e ndalimit.

Me rëndësi është të dihet se, kur diçka është absolute, nënkupton që ajo është e plotë. Kështu, besimi absolut, është besimi i plotë; Islami absolut, është Islami i plotë; teuhidi absolut, është teuhidi i plotë; shpëtimi absolut, është shpëtimi i plotë.

Absolutja e diçkaje është grada më e ulët e saj apo edhe një shkallë e saj. Kështu, absolutja e besimit është grada më e ulët e tij. Themi për shembull: kjo bie në kundërshtim me besimin absolut, domethënë që bie totalisht në kundërshtim me besimin e plotë. Ose themi: kjo bie në kundërshtim me absoluten e besimit, domethënë bie në kundërshtim me shkallën më të ulët të besimit.

Nëse është e qartë kjo atëherë themi: Humbja (e shprehur në hadith) mund të nënkuptojë humbjen absolute, por ajo varet edhe nga gjendja e personit. Kështu, nëse njeriu beson se përdorimi i atyre gjërave ndikon në mënyrë të pavarur, ai është prej banorëve të Zjarrit. Nëse mendon se ato janë vetëm shkaqe, ai edhe në këtë rast është prej banorëve të Zjarrit, por nuk do të qëndrojë aty përgjithmonë, siç ndodh me monoteistët gjynahqarë.

Autori thotë: Ukbe Ibn Amir transmeton se Profeti – paqja dhe bekimi i Allahut qoftë me të! – ka thënë: “Kush vendos hajmali, Allahu mos ia plotësoftë! Kush var guaskë, Allahu mos i dhëntë rehati!”<sup>25</sup>

Shohim fjalën "*el teal-luk*", që shënon rastin kur dikush mban një send të lidhur në trup dhe e ka zemrën të lidhur me të. Hajmalia ka një kuptim tjetër, që do të shpjegohet në vijim, në dashtë Allahu. Hajmalia është e përbërë nga rruaza dhe gjëra të tjera dhe vendoset në kraharor të fëmijëve më shumë, por mund ta mbajnë edhe të rriturit, me qëllim largimin e mësyshit apo të gjërave të pakëndshme, të smirës, ndikimit të shejtanëve etj.

Thënia "Allahu mos ia plotësoftë" është lutje për atë njeri që mban nga këto gjëra, që Allahu të mos ia realizojë dëshirën. Fjala "*el temime*" (hajmalia) e merr kuptimin e saj nga realizimi me sukses i diçkaje. Është quajtur e tillë pasi personi që e mban një të tillë beson se me të do t'i realizohet qëllimi, ndaj dhe Profeti

<sup>25</sup> Shënon Ahmed: 4/154; nr: 17404. Ebu Jeala: 3/295; nr: 1759. Ibn Hibani: 13/450; nr: 6086.

(Paqja e Allahut qoftë mbi të!) u lut që Allahu i Madhërishëm të mos ia përmbushë qëllimin.

Thënia "dhe kush var guaskë Allahu mos i dhëntë rehati!". "*El uedea*" është një lloj guaske, që njerëzit e vendosin në gjoks, në shpatull etj., me qëllimin e largimit a të pengimit të mësyshit e gjërave të tjera të padëshirueshme. Kuptimi i lutjes "Allahu mos i dhëntë rehati!" mund të jetë mallkim ose domethënë: mos e lëntë të qetë dhe mos gjetë prehje! Profeti (a.s.) është lutur në këtë mënyrë pasi ai njeri i ka bërë shirk Allahut të Madhërishëm. Autori thotë: "Në një tjetër transmetim thuhet: "Kush var hajmali, ka rënë në shirk." Kjo pasi mbajtja e hajmalive dhe lidhja e zemrës me to është shirk i vogël, por mund të jetë edhe i madh, në varësi të personit, sikurse do të flitet në mënyrë të detajuar në vijim, me leje të Allahut të Madhërishëm.

Autori thotë: Ibn ebi Hatim përcjell hadithin e Hudhejfes se ai kishte parë njëherë një person që mbante të lidhur në dorë një fije peri për t'u shëruar nga ethet. Ai ia këputi menjëherë perin dhe lexoi ajetin kuranor: "[Shumica e tyre nuk besojnë në Allahun pa i shoqëruar Atij njëkohësisht \(idhuj të rremë\) në adhurim.](#)"<sup>26</sup> Përkimi i këtij hadithi me kapitullin është i qartë. Sahabi Hudhejfe pa një njeri që në dorë kishte vendosur një fije peri për ethet dha ai ia këputi, duke i thënë se një gjë e tillë është shirk dhe duke ia provuar me ajetin e mësipërm. "*Min*" është parafjalë shpjeguese, domethënë se ai e kishte lidhur perin për të larguar apo parandaluar temperaturën.

Thënia "Ai ia këputi" tregon se mbajtja e perit ishte e papranueshme, prandaj ia këputi menjëherë.

"Dhe lexoi: "[Shumica e tyre nuk besojnë në Allahun, pa i shoqëruar Atij njëkohësisht \(idhuj të rremë\) në adhurim.](#)"<sup>27</sup> Disa nga të parët tanë kanë thënë që kuptimi i ajetit "[Shumica e tyre nuk besojnë në Allahun](#)" është: "edhe pse ata e pranojnë se Allahu është Krijuesi, Furnizuesi, Ai që jep jetë dhe që sjellë vdekjen, edhe pse e njësijnë në teuhidin rububije, përsëri ata "...i shoqërojnë Atij njëkohësisht (idhuj të rremë) në adhurim.". Nga kjo kuptojmë se njësimi i Allahut në teuhidin rububije nuk është i mjaftueshëm për të shpëtuar, por duhet që atij patjetër t'i shtohet edhe teuhidi i adhurimit.

Edhe pse ajeti bën fjalë për shirkun e madh, argumentimi përmes tij për shirkun e vogël është i saktë. Këtë na e tregon edhe autori, kur thotë: "Leximi i ajetit

<sup>26</sup> JÛSUF: 106.

<sup>27</sup> JÛSUF: 106.

kuranor nga Hudhejfa tregon se sahabët bazoheshin te ajetet ku përmendet shirku i madh për t'iu referuar shirkut të vogël.”